

PLANI STRATEGJIK PËR TRASHËGIMI
KULTURORE DHE NATYRORE PËR
KOMUNËN E ISTOGUT
2023 – 2027

(Draft 15.12.2022)

HYRJA.....	3
METODOLOGJIA.....	3
TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E ISTOGUT	4
Trashegimia kulturore e Komunës së Istogut	4
Trashegimia natyrore - Resurset minerare	4
Shpellat ,si vendbanim I njeriut në parahistori	5
Trashëgimia arkeologjike	6
Trashegimia arkitektonike.....	9
Veshja e Podgurit	12
GJENDJA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE.....	13
HISEDARET	14
ÇËSHTJET KYQE DHE GRUPET PUNUESE	15
ANALIZA SWOT	16
1. Përfshirjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në edukimin primar dhe sekondar	17
2. Trajtimi e trashëgimisë në zhvillimet urbane, mjedisor dhe sociale	17
3. Roli i trashëgimisë kulturore në ndërmarrësi dhe industri krijuese;	18
4. Bashkëpunimin ndërinstytucional	19
5. Promovimin e regjionit të Istogut përmes resurseve të kulturore dhe natyrore.	20
VIZIONI DREJT TE ARDHMES.....	21
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	21
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME	21
Objektiva e përgjithshme 1 : Integrimi i trashëgimisë kulturore në programet e edukimit primar dhe sekondar dhe profesinal	22
Objektiva e përgjithshme 2: Mbrojta e vlerave/resurseve kulturore nga zhvillimet urbane, mjedisore dhe sociale	22
Objektiva e përgjithshme 3: Zhvillimi i Ndërmarrësisë dhe industrisë krijuese me fokus në trashegimi kulturore.....	23
Objektiva e përgjithshme 4: Nxitja e bashkëpunimit dhe krijimi i mekanizimit institucional për menaxhimin e resurseve kulturore dhe natyore - krijimi i organizimit institucional	23
Objektiva e përgjithshme 5: Promovimi i Istogut si destinacion i kultures dhe natyrës	24

HYRJA

Komuna e Istogut është rajoni i më i pasur me trashëgimië kulturore dhe natyrore në Kosovë. Sipas Listës së Përkohshme të Trashëgimisë kulturore të publikuar në vitin 2022, Komuna e Istogu ka 28 lokalitete arkeologjike, dhe 32 monumente arkitektkonike. Mirëpo sipas informative nga terreni, janë të identifikuar mbi 100 lokalitete arkeologjike, shpella parahistorike, kulla të gurit, mullinjtë, veshja karakteristike e Podgurit, pasurit natyrore të bjeshkëve dhe burime ujore. Mirëpo keto potenciale mbasin të pashfrytëzuara, ose pjesërisht të shfrytëzuara për shkak të politikave joadekuata ndaj resurseve zhvillimore lokale. Politika për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zhvilluara nga niveli qendror I qeverisjes janë të fokusuara kryesisht në identifikimin e vlerave, përfshirja në Listën Zyrtare të Trashëgimisë kulturore dhe natyrore, në intervenimet konzervuese, por shumë pak në integrimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në politikat e zhvillimit lokal. Me fjalë të tjera, potenciali kryesor I zhvillimit lokal është i lënë pas dore, dhe si rrjedhojë gjendja ekonomike në komunë është jostabile duke bërë që popullata lokale të migroj nga kjo komunë.

Strategjia për Trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Istogut ka për qëllim që të vë në pah këtë potencial si burimi kryesor I zhvillimit. Për ta bërë këtë, Strategjia është e fokusuar në zhvillimin e resurseve njerëzore si parakusht për një mobilizim të ri socio-ekonomik lokal në të mirë të mirëqenies dhe kohezionit shoqëror. Strategjia adreson çështjen e organizimit dhe bashkëpunimit dhe politikave të mbrojtjes së këtyre resurseve gjatë zhvillimeve urbane.

METODOLOGJIA

Procesi për hartimin e Strategjisë Komunale Për Trashëgiminë Kulturore dhe Natyrore ishte pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës. Përmes një analizë të hisedarëve janë identifikuar dhe përzgjedhur përfaqësues të institucioneve lokale, ndermarrjeve publike dhe nga shoqëria civile.

Në fazen e parë janë analizuar çështjet/problemet kyqe në fushen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndërlikohet me:

1. Përfshirjen e kufizuar të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në edukimin primar dhe sekondar;
2. Neglizhencën në trajtimin e trashëgimisë në zhvillimet urbane, mjedisor dhe sociale;
3. Mungesën e rolit të trashëgimisë kulturore në ndërmarrësi dhe industri krijuese;
4. Bashkëpunimin jo të qendrueshëm ndër-institucional, dhe
5. Mungesën e promovimit të regjionit të Istogut përmes resurseve të kulturore dhe natyrore.

Për secilën nga keto tema, janë krijuar focus grupet në përbërje të përfaqësuesve të institucioneve komunale dhe të shoqërisë civile. Fokus grupet kanë punuar në një seri prej tri punësive për secilën çështje. Në punëtorinë e parë, për secilën prej temave është hartuar analiza SWOT përmes së cilës është analizuar gjendja aktuale (përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kanosjet). Në punëtorinë e dytë janë hartuar objektivat specifike për secilën temë përkatëse. Objektivat janë bazuar në analizen SWOT. Punëtorja e tretë është fokusuar në hartimin e Planit të Veprimave, ndërkaq punëtorja e katërt ka prodhuar Planin Buxhetor dhe kalendarin e zbatimit të aktiviteteve.

TRASHEGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E ISTOGUT

Trashegimia kulturore e Komunës së Istogut

Komuna e Istogut, shtrihet në veriperendim të Kosovës, ka 46 zona kadastrale, më një sipërfaqe, prej 453.84 km². Më 51 fshatra dhe qendën komunale dhe katër qendra nderurbane : Rakoshin , Vrellën , Gurrakocin dhe Banjën. Më një infrastrukturë të mirë rrugore. Kjo komunë në verilindje kufizohet më Zubin Potokun, në Lindje më Skenderajin, në jug më Klinën, në jugperendim dhe perendim më Pejën dhe në veri më Serbinë dhe Malin e Zi.

Trashegimia natyrore - Resurset minerare

Istogu si komunë është e pasur edhe më resurse nëntoksore: ka 2 miliard ton thengjill-lugina e lumit Gujavq, në kuadër të basenit të thengjillit-linjit të Dukagjinit. Në Tuqep është e identifikuar më shpim gjellogjik, 60 m. **potenca e shtresës së linjtit** . Banja-Ilixhja , e njohur për ujin shërues termomineral, që nga periudha parahistorike , është njëherazi edhe vendburim potencial i **mermerit onix** të cilësisë elite. Rezerva të mermerit ka edhe në fshatin Syne, si dhe Studenicë. Mermeri është përdorur për punimin e **veprave të artit** , por edhe si gur dekorativ në objekte fetare si xhamia , kisha , kulla, ura etj. Një shtyllë , monolit mermeri , e Banjës, ndodhët në mbërthimin arkitektonik të Pallatit të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.



Foto 1 Burimi i ujit termomineral në Banjë .për rreth së cilës janë te deponuara rezerva million toneshe të mermerit dhe bigrit, si efekt i gjeoenergjisë.

Malët e Moknës, ky masiv malor, tek Rusolia puqet më Alpët Veriore Shqiptare, për të vazhduar në drejtim të lindjes deri tek lumi Gujavq në Syriganë, i cili shenjëzon kufirin natyral midis Istogut si komunë dhe trevës së Drenicës . Lartësia mbidetare e Maleve të Moknës shkon deri në 2155 m.

Malet e Moknës janë të formesuara gjatë orogjenezës Alpine dhe **gelqeroret**, që gjemorfologjikisht përbëjnë katin e epër shkëmbor, janë të vendosur, mbi serinë diabaz-stralore (shkëmb magmatik), e cila përbën, njëherazi shkëmbin hidroizolator , i cili e pengon infiltrimin gravitativ të ujit, duke e detyruar atë të shperthei në trajtë të burimeve të fuqishme të ujit, si **Istogu**, më 2.5 m³/sec, **Vrella** më 0.9m³/sec dhe një numër të madh **krojesh** , që burojnë në rranzin e bjeshkës. Burimet e fuqishme karstike Istogu dhe Vrella , janë hidromonumente, që



Foto 2 Burimi I Istogut, me kapacitet 2.5 m³/sec

shpërthejnë në lartësi mbidetare 480 e 514 m. - burojnë në të njëjten lartësi mbidetare, duke dhënë edhe emertimin e Podgurit si trevë e veçantë. Është fjala për rrafshin hidroizolator-shkëmbi magmatik, midis këtyre tri burimeve të ujit, I cili nga popullata vendore është quajtur: “Pod I Gurit”. Zonë e ujigrumbullimit është gjithë masivi gelqeror, I cili është I thyer e tektonizuar, më një hipërkapilaritet, nëpër të cilin uji gravitativisht, lëviz lirshëm deri të prita -shkëmbi magmatik, I cili është kompakt në aspektin e ujimbajtjes. Një sasi e këtij uji shpërthen në trajtë burimësh e krojësh dhe sasia tjetër rrugëton nën mbulesën proluviale duke u drenuar në Rrafshin e Podgurit, për të ushqyer më uji shtesën ujimbajtëse- ranore.

Ky masiv malor ka një biodiversitet të pasur, më pyje ,kullota si : Lugu I Butë, Livadhet e Istogut, Vojdolli dhe Mokna, më burime të ujit .

Shpellat ,si vendbanim I njeriut në parahistori

Në llogari të çarjeve tektonike dhe fenomenit të karstit, në masivin e maleve të Moknës ,janë të formësuara një numër jo I vogël I **shpellave**, të cilat janë **gjeomonumente** të Komunës së Istogut dhe sipas arkeologve janë potencialisht interesante si strehë e njeriut në parahistori-Mezolit dhe Paleolit. Shpellat ,jane të numerta (të evidentuara 22 deri me tani) , shumica të mermeritizuara.



Foto 3 Shpella e shkëmbit të xhveshur-Gollostenës ,nën livadhet e Vojdollit,më 132m. koridore, 1230m. të lartësisë mbidetare , e mermeritizuar,e formësuar në llogari të një çarje tektonike VL-JP.

Malët e Moknës kanë potencial të mirë për :kultivimin e peshkut,bletari,**zhvillimin e turizmin malor**,shtigje për skijim,alpinizëm,spelologji,prodhim I agregateve të gurit të bluar,plantacioneve ekologjike(dredhëza,mjedra,manaferra,patatja),si dhe blegtori.

Trashëgimia arkeologjike

Komuna e Istogut është e begatshme më vlera të trashëgimisë kulturo-historike.

Trashëgimia arkeologjike:Sipas ekspeditave përnjohëse të IAK-viti 2005 dhe 2016 , janë të piketuara **116 lokalitete arkeologjike**,më shtrirje kohore nga Neoliti e deri në Mesjetën e Vonë.



Foto 4 Sopatë e strallit e Neolitit-Rakosh,lokaliteti “Sredorekë”



Foto 5 Lokaliteti arkeologjik- “Bregu I kishës” Studenicë, shek. IV-VI të e.s.



Foto 6 Dionisi , Zoti I rrushit dhe I venës shek.II te e.s vendbanimi Ilir I forifikuar “Krye” Vrellë.



Foto 7 Stellë mbivarrorre ,dardane , Gjyshkokë-Kaliqan, shek. II e.s.



Foto 8 Lulja e jetës, Ylli i Davidit më syrin e masonit dhe pema e jetës ,Shushicë.



Foto 9 Ura e gurit Zallq shehk. XVII mbi lumin Istog më 13 harqe qemer.

Trashegimia arkitektonike

Komuna e Istogut, ka 42 kulla dy e tri kateshe, 8 mullinjë më ujë, 13 xhami, 5 kisha ortodokse serbe, 1 kishë katolike shqiptare, 1 urë guri, arkitektonikë osmane. Ky numër i objekteve të trashëgimisë kulturore historike ishte dukshëm më i madh, por në luftën e fundit, janë zhdukur më ekspeditat zjarrvënëse e granatuese të rexitit serb-është bërë kulturocid i egër mbi këto vlera të trashëgimisë. Janë restauruar në numër i kullave, xhamijave, kishave, mullinjëve më uji, ura e gurit në Zallq, është themeluar Muzeu Komunal dhe të gjitha se bashku ia shtojnë **potencialin turistik** komunës së Istogut.



Foto 10 Kulla e Qerim Rugovës ,projeksioni ballor e ndërtuar në shek. XX-një pjesë të jetës feminare e kaloi në të ,Dr.Ibrahim Rugova ,presidenti historik i Kosovës .



Foto 11 Sistemi për bllojë, mulliri i Qelë Biciti, Vrellë- 4 breza I vjetër.



Foto 12 Mulliri I Niman Shabanve,Istog,më 5 gur ,I ndertuar më 1703



Foto 13 Xhamia e vjeter e Istogut e ndertuar ne 1730, e restauruar pas djegjes dhe granatimit nga regjimi serb.



Foto 14 Kisha serbe , e Shen Gjonit,Cerkolez,shek XIV.

I themeluar ,në vitin 1999,pas lufte , në Pallatin e Kulturës “Adem Jashari” në Istog.



Foto 15 Kuarti Etnologjik



Foto 16 Kuarti arkeologjik

Veshja e Podgurit

Në thesarin e 140 veshjeve, sa ka kostumografia shqiptare për femra, Veshja e Podgurit, është më taban ilir, e dizajnuar nga stergjyshet tona, Dardane 2500 vite më parë. Djepi i formësimit të kësaj veshje, është treva e Podgurit, kurse etnozonë i gjithë Rrafshi Dukagjinit. Elementet kostumografike, si: mbuloja e kokës, më “lidhcë e mahramë”, veçanti dalluese, i përngjet kurorës së princeshës ilire. Këmisha është identike me Dallmatiken ilire. Brezi i fortifikuar për krahor, ka sherby për bartjen e burielës më uji. Brezi i takon dizajnit ilir të origjinës së veshjës, i cili në periudhën osmane u shëndrrua në xhamadan. Bazuar në shtrirjen e saj gjeografike - etnozonën, bukurinë dhe vjetërsinë, e propozoi dhe këmbënguli, që Veshja e Podgurit, të përvetësohet si **brend i kulturës shpirtrore të Dukagjinit**, në fushën e etnologjisë.



Foto 17 Veshja e Podgurit, versioni Ilir

Bazuar në thesarin e vlerave të trashëgimisë, ka kushte potenciale për zhvillimin e **turizmit rural**- duke i restauruar kullat dhe mullinjët më ujë të trevës së Podgurit, duke ndërtuar infrastrukturën rrugore deri të vendgjetjet arkeologjike, vazhduar ekspeditat e gërmimeve arkeologjike, si dhe duke përcaktuar zonën e mbrojtur të lokalitetit arkeologjik.

Finalisht sot me ndihmën profesionale të CHëB dhe akterve komunal synojmë ta ndertojmë një **plan strategjik komunal të trashëgimisë kulturore** ,të bazuar në parametra të matshëm,e në unison më mundësitë buxhetore ,të Komunës së Istogut e Republikës së Kosovës .

(Enver Boletini , zyrtar I trashëgimisë kulturore në komunën e Istogut)

GJENDJA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë UNESCO trashëgiminë kulturore e definon si ‘një trashëgimi e artefakteve (strukturave) fizike dhe attributeve të paprekshme (shpirtërore) të një grupi ose shoqërie që trashëgohen nga brezat e kaluar, të ruajtura në të tashmen dhe të dhuruara për të mirën e brezave të ardhshëm’.

Nisur nga ky definicion, themi se trashëgimia kulturore në Republikën e Kosovës përfshinë të gjitha sturkturat fizike (struktura ndërtimore, artefakte) dhe attribute shpirtërore të krijuara gjate shekujve në territorin e Republikës së Kosovës, të cilat janë trashëguar nga brezat e kaluara dhe të cilat duhet të ruhen dhe të mbrohen për brezat që vijnë.

Ruajtja dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës është e garantuar ne Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në nenin 9 të Kushtetutës është përcaktuar që “Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare” neni 9 ¹

Kuvendi i Kosovës ka miratuar legjislacion të avancuar për mbrojtje dhe ruajt të trashëgimisë kulturore. Ligji aktual për trashëgimi kulturore është hartuar me asistencë të ekspertëve të Keshillit të Evropës. Me tutje, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka hartuar edhe ligje të tjera të cilat sigurojnë mbrojtje shtesë për trashëgiminë kulturore me të cilën identifikohen grupet minoritare në Kosovë.

Mirëpo, gjendja në trashëgimia kulturore dhe natyrore në Komunën e Istogut nuk është e kënaqshme. Përkundër disa intervenimeve emergjente dhe restauruese, shumica e monumenteve janë lënë pasdore dhe si rrjedhojë ato vazhdojnë të degradohen, të rrenohen dhe të zhduken. Intervenimet emergjente dhe restauruese nuk janë të shoqëruara me plan të qëndrueshmërisë në mënyrë që monumentet të kthehen në shërbim të shoqërisë.

Shumica e monumenteve arkitektonike, të cilat janë demtuar gjatë luftës dhe ato te cilat për shkak të mirëmbajtjes së dobët janë degraduar, tashmë kanë mbetura rrenoja, ndërkaq trashëgimia arkeologjike është e trajtuar vetëm në nivelin e evidentimit dhe “gërmimeve me karakter shkencor” por pa intervenime konzervuese të cilat sigurojnë ruajten e integritetit fizik të

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës

tyre. Institucionet përgjegjëse ende nuk i kanë definuar zonat mbrojtëse të këtyre monumenteve dhe si rrjedhojë hapëisra e tyre gjithnjë e më shumë ngushtohet si pasojë e zhvillimeve urbane.

Shkaqet e kësaj gjendje janë të ndryshme. Ato ndërlidhen me kapacitetet institucionale për zbatim të politikave nacionale, me performancën institucionale veçmas të institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore; me koordinimin ndërsektorial, sidomos sektorit të trashëgimisë me sektorin e planifikimit hapësinor dhe sektorin e infrastrukturës. Gjithsesi, gjenda e trashëgimië kulturore është e ndërlidhur edhe me sundimin e ligjit dhe performancën e sistemit juridik. Ndeshkimet për keqbërësit në trashëgimi janë tejet minimale dhe shpesh lëndet në gjykata janë të lëna pasdore.

Si pasojë e kësaj gjendje trashëgimia kulturore vazhdoj të mbetet barrë e shoqërisë. Të gjitha investimet në trashëgimisë vijnë nga buxheti i publik dhe nga fondet ndërkombëtare ndërsa rikthimi në investimet është tepër i ulët.

Në anën tjetër, trashëimia natyrore dhe në përgjithësi potencialet natyre të Istogu kanë pasur një vemendje më të madhe gjatë 4-5 viteve të fundit. Jane evidentuar dhe shenjëzuar shtigje të reja të ecjes (hiking), janë identifikuar dhe hulumtuar shpellat, si dhe është mbështetur komuniteti lokal në adaptimin e hapësirave për akomodim dhe mikëpritje të turistëve. Me tepër, në Istog ka pasur edhe organizime të ndryshme të sporteve outdoor, një më I veçanti është paragllajdi. Mirëpo, sikurse edhe në pjesët tjera të Kosovës, prerjet ilegale dhe ndërtimet e pakonrolluara e kane degraduar sipërfaqen pyjore, duke I shkaktuar dëme florës dhe faunës.

HISEDARET

	Institucioni	Përfaqësimi vendimarrës	Lloji
1	Kryetari i Komunës	Kryetari	
2	Drejtoria e Kulturës	Drejtori + Stafi	
3	Drejtoria Edukimit	Drejtori + Stafi	
4	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Drejtori + Stafi	
5	Drejtoria e Urbanizmit	Drejtori + Stafi	
6	Drejtoria e Bujqësisë	Drejtori + Stafi	
7	Drejtoria e Kadastrit	Drejtori + Stafi	
8	Klubi Letrar Podguri		OJQ
9	OJQ Folklori i Podgurit		OJQ
10	SHH Ali Hadri		OJQ
11	OJQ Aba		OJQ

12	OJQ Vizioni 02		OJQ
13	Klubi Alpin Podguri		OJQ
14	OJQ Shoqata e fermereve		OJQ
15	Shoqata e Gjuetareve “Gurrat e Bardha”		OJQ
16	TROFTA		Biznes
17	Agroprodukt		Biznes
18	Blif (Çaj)		Biznes
19	Agro Kovraga		Biznes
20	Ukë Gjema		Profesor i Etnologjise
21	Shefqet Gjoci		Kulturolog
22	Agon Ceta		Biznes
23	AN Production (Armend Neziri)		Biznes
24	Shefqet Mavraj		Piktor
25	Rexhë Fetahu		Piktor
26	Ndërmarrja “Ambienti”		NP

ÇËSHTJET KYQE DHE GRUPET PUNUESE

Përmes një procesi pjesëmarrës janë evidentuar pesë çështje kyqe të cilat duhet të adresohen brenda dokumentit të Strategjisë. Keto çështje janë gjetur përmes pyetjes se “Cilat janë sfidat kryesore në menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Komunës së Istogut”. Përmes grumbullimit të përgjigjeve, dhe tematizimit të tyre janë renditur këto çështje kyqe:

1. *Resurset njerëzore dhe politikat e edukimit për trashëgimi kulturore dhe natyrore*
2. *Përfshirja e trashëgimia kulturore dhe natyrore në zhvillimet urbane dhe sociale*
3. *Zhvillimi ekonomik përmes trashëgimisë kulturore dhe natyrore*
4. *Sfidat e bashkëpunimit në mes hisedarëve*
5. *Promovimi i Istogut përtej kufijëve komunal*

Mëqenëse secila nga çështjet kyqe kërkon analizë sektoriale duke përfshirë hisedarë nga institucionet publike dhe shoqëria civile. Grupet punuese të përfshira në analizë janë të renditura më poshtë:

1. *Resurset njerëzore dhe politikat e edukimit për trashëgimi kulturore dhe natyrore*

Mirjeta Shatri
Enver Boletini
Ramë Thaçi
Jusuf Mavraj
Naim Sadrijaj

2. *Përfshirja e trashëgimia kulturore dhe natyrore në zhvillimet urbane dhe sociale*

Enver Boletini
Agon Dreshaj
Alfred Tahirsylaj
Elianë Blakaj
Elfete Blakaj

3. *Zhvillimi ekonomik përmes trashëgimisë kulturore dhe natyrore*

Masar Kabashi
Mirjeta Shatri
Armend Delijaj
Regjë Mulaj
Enver Boletini
Valbonë Kaliqanaj
Fadil Kabashi

4. *Sfidat e bashkëpunimit në mes hisedarëve*

Ilri Ferataj
Elianë Blakaj
Enver Boletini
Ismet Demaj
Masar Kabashi

5. *Promovimi i Istogut përtej kufijëve komunal*

Masar Kabashi
Muhamet Gusturanaj
Ismet Demaj
Regjë Mulaj
Enver Boletini
Jusuf Mavraj

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është teknikë menaxhimit dhe planifikimit strategjik që shërben për identifikimin e Perparësive, Dobësive, Mundësive dhe Kanosjeve të ndërlidhuar me temën e analizuara. Në vazhdim janë listuar tabelat SWOT për Pesë (5) Çështjet kyqe të identifikuara nga hisedaret:

1. Përfshirjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në edukimin primar dhe sekondar

Në përgjithësi, siç u tha me lartë, Komuna e Istogut është e pasur me trashëgimi kulturore dhe natyrore. Kjo pasuri është e shprehur në formën e saj ndërtimore, peizazhore dhe shpirtërore. Mirëpo, programi shkollor primar dhe sekondar në mas shumë të vogël përfshin këto pasuri në kurrikulat e edukimit. Nxënësit kanë ndërveprim shumë të kufizuar me këto pasuri, me shumë në formë të ekskurzioneve dhe vizitave private por jo edhe në lëndë specifike sic janë historia, edukata qytetarë, mjedisi etj.

Përmes qasjes strategjike do të ishte e mundur që Komuna e Istogut të shendërrohet në një ‘muze të hapur’ të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në të cilin nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme do të jenë të përfshirë në mësimnxënie dhe të inspiruar për të vazhduar të merren me diciplinat kulturore dhe mjedisore.

ANALIZA SWOT - ÇËSHTJE KYQE 1: Përfshirjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në edukimin primar dhe sekondar	
PËRPARËSITË 1. Istogu është i pasur me asete të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. 2. Kemi kuadër dhe infrastrukture të nevojshme për promovimin e trashëgimisë kulturore. 3. Ka përkrahja e institucioneve komunale për integrimin e trashëgimisë kulturore në edukim.	DOBESITË 1. Mungesa e përkujdesjes së rregullt të insitucionëve perkatëse dhe e faktorit njeri në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. 2. Mungesa e vizitave e nxënësve në monumenteve kulturore dhe historike dhe arkeologjike. 3. Mungesa e literaturës për trashegimi kulturore dhe natyrore. 4. Mungesa e infrastrukturës të përshtatshme për pritje të vizitorëve në lokalitete arkologjike 5. Mungesa e kontetit/ narracioni për vendet historike.
MUNDËSITË 1. Përfshirja e integritit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në programet e eduktimit primar dhe sekondar 2. Krijimi i një zonë pasur (muze i hapur) me trashëgimi kulturore 3. Krijim të kuadërit të mjaftueshëm për zbatimin e programit edukativ në trashëgimisë kulturore dhe natyrore	RREZIQET 1. Mungesa e buxhetit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore 2. Mungesa e vullnetit politik për ndryshim të programeve edukative

2. Trajtimi e trashëgimisë në zhvillimet urbane, mjedisor dhe sociale

Komuna e Istogut ka të hartuar Planin Zhvillimor komunal i cili është një dokument strategjik mbiu zhvillimet hapësinore dhe urbane. Megjithatë, zhvillimet urbane në komunën e Istogut janë

të pjesërisht të kontrolluara në zonën urbane të komunës, ndërsa në zonat rurale zhvillimet urbane janë plotësisht të pakontrolluara, sidomos ndërtimet. Situata përkeqësohet edhe me tepër për shkak se lokalitetët e trashëgimisë kulturore nuk e kanë të definuar zonat mbrojtëse. Për pasojë, shumë ndertime cenojnë hapësirën rrethuese të lokaliteteve të trashëgimisë, duke bërë që shumë prej lokaliteteve të trashëgimisë kulturore degradohen dhe shkatërrohen. Institucionet përgjegjëse nuk e monitorojnë situatën dhe për pasojë gjendja vazhdon të përkeqësohet. Hisedarët, përmes një qasjeje të re, duhet të angazhohen në integrimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në planet zhvillimore komunale përmes definimit të zonave me rëndësi të veçantë kulturore dhe përfshirjes komunitare në vlerësimin dhe menaxhimin e këtyre hapësirave.

ANALIZA SWOT - ÇËSHTJE KYQE 2: Trajtimi e trashëgimisë në zhvillimet urbane, mjedisor dhe sociale;	
PËRPARËSITË 1. Komuna e Istogut ka shtrirje të asetëve të trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin e komunës. 2. Qasja në lokacionet e trashëgimisë është e lehtë përmes rrugëve lokale.	DOBESITË 1. Asetët e trashëgimisë kulturore demtohen për shkak të mirembajtjes së pamjaftueshme 2. Asetët e trashëgimisë kulturore demtohen për shkak të zhvillimeve, urbane dhe infrastrukturore 3. Asetët e trashëgimisë kulturore nuk i kanë të definuara perimetrat dhe zonat mbrojtëse. 4. Mungesa e përkujdesjes dhe monitorimit institucional nga institucionet qendrore.
MUNDËSITË 1. Definimi i hapësirave me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore dhe natyrore 2. Përfshirja e asetëve të trashëgimisë kulturore në Planet lokale hapësinore 3. Përfshirje së komunitetit lokal për vlerësim të trashëgimisë kulturore.	RREZIQET 1. Demtimi dhe zhdukja e trashëgimisë kulturore për shkak të zhvillimeve hapësinore

3. Roli i trashëgimisë kulturore në ndërmarrësi dhe industri krijuese;

Industria kreative është fushë e re e cila bazohet në resurset kreative kulturore të një hapësirë të caktuar gjeografike. Industria kreative kryesisht fokusohet fushat kreative artistike, arkitekturë, dizjan, modë, medie audiovizuale, arte performuese, IT, kulinari etj. Në këtë aspekt, trashëgimia kulturore është faktor kyç për inspirim. Për ta bërë këtë nevojitet një qasje e re lokale duke krijuar mundësi për të hulumtim të të gjitha formave të trashëgimisë kulturore, prezantim të tyre dhe mbështetje për sektorin e industrisë kreative.

ANALIZA SWOT - ÇËSHTJE KYQE 3: Roli i trashëgimisë kulturore në ndërmarrësi dhe industri krijuese;	
PËRPARËSITË 1. Thesar i bollshëm i vlerave të trashëgimisë kulturore & natyrore (arkeologjike, arkitektonike, industriale etj.) 2. Trashëgimia shpirtërore - etnologjike (identifikimi me veshjen e podgurit, folklor burimor etj.) 3. Evidentimi i shumices se asetëve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore 4. Përfshirja në mbrojtje ligjore nga ana e shtetit të disa nga asetët. 5. Produktet turistike në bjeshket e Komunës së Istogut 6. Komuniteti bjeshkatar është aktiv në sferën e turizmit 7. Themelimi i Muzeut të Komunës	DOBESITË 1. Trashëgimia kulturore nuk konsiderohet si resurs zhvillimi 2. Potenciali i mundshëm i arsimuar kërkon mundësi të reja jashtë komunës së Istogut 3. Mungesa e mbështetjes insitucionale për rehabilitimin e hapësisave të trashëgimisë kulturore 4. Mungesa e legjislacionit për partneritet public-privat për asetët e trashëgimisë kulturore
MUNDËSITË 1. Aktivizimi dhe funksionalizimi dhe rijetësimi i trashëgimisë kulturore 2. Përfshirja e të rinjeve në tregun e punës 3. Krijimi i ndërmarrjeve të reja në sektorin e turizmit kulturor 4. Krijimi i një fondi të veçant për ndërmarrje të reja	RREZIQET 1. Migrimi i popullsisë 2. Dëmtimi i asetëve nga faktori ‘kohe’ 3. Mungesa e vullnetit politik

4. Bashkëpunimin ndërinstytucional

Bashkëpunimi ndërsektorial dhe ndërinstytucional është askepti kyç i mbrojtjes se trashëgimisë kulturore. Sipas legjislacionit në fuqi, autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Mirëpo rol të rëndësishëm kanë edhe autoritetet komunale të cilat merren me menaxhimin ditor të territorit të tyre, si dhe shoqëria civile që janë shfrytëzues dhe konsumues të trashëgimisë kulturore. Deri me tani këta hisedarë nuk kanë arritur të ndërtojnë ndonjë mekanizëm të përbashkët të komunikimi dhe bashkërendimit të aktiviteteve. Sipas modeleve të aplikuara në vende të tjera, është e nevojshme krijimi i grupeve të përbashkëta me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore duke synuar ruajtjen e vlerave dhe përdorimin e saj për zhvillim lokal.

ANALIZA SWOT - ÇËSHTJE KYQE 4: Bashkëpunimin ndërinstytucional	
PERPARESI	DOBESITE

1. Vullneti i inisitucioneve komunale për mbrojte dhe menaxhim të trashëgimisë kulutorore. 2. Shoqëria civile aktive dhe e vetdijshme për rëndesinë e trashëgimisë kulturore 3. Frymë positive për bashkëpunim në mes të insitucioneve komunal dhe shoqërisë civile	1. Nuk ekziston një organ i përbashkët i hisedareve për t'i adresuar çështjet që lidhen me trashëgimi kulturore dhe natyrore 2. Trashëgimia kulturore është në margjina të zhvillimet lokale
MUNDËSITË 1. Krijimi i një komiteti të përbashkët të institucioneve komunale dhe shoqërisë civile për mbrojte dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore. 2. Krijim i një modeli pozitiv për menaxhimin e trashëgimisë kulturore si model për zhvillim lokal	RREZIQET 1. Mungesa e vullnetit politik,

5. Promovimin e regjionit të Istogut përmes resurseve të kulturore dhe natyrore.

Komuna e Istogut është një prej komunave me të pasura me trashegimi kulturore dhe natyrore në Kosovë. Vendet arkeologjike, kullat e gurit si dhe bjeshkët e pasura janë disa nga këto pasuri. Mirepo, në mungesë të promovimit, Istogu nuk ka është i njohur nga publiku në nivel te vendit dhe me gjerë. Komuna deri tani nuk ka qenë në gjendje të krijoj një platformë promovuese, dhe as ndonjë zyrë turistike e cila do të ishte në shërbim të vizitorëve. Aq me pak, monumentet të cilat gjenden në teritorin e komunës nuk janë të pajisjura me shenjëzim dhe me interpretim adekuat në lidhje me vlerat e tyre.

Sot, ndërkaq do të ishte një mundësi e mirë që të shfrytezohen mundësitë reja teknologjike dhe kreative për krijimin e një platforme online, ndërsa edhe të aktivizohet zyra turistike ne qendrën e qytetit, si dhe të ndërtohen narracionet për vendet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të komunës.

ANALIZA SWOT - ÇËSHTJE KYQE 5: Promovimin e regjionit të Istogut përmes resurseve të kulturore dhe natyrore.	
PERPARESI 1. Istogu, komunë me pasuri kulturore dhe natyrore 2. Shumica e monumenteve janë te evidentuara 3. Pozita gjeografike e Komunës se Istogut, pranë Bjeshkëve të Nemura 4. Disa nga monumentet jane ne listen e trashegimise kulturore	DOBESITE 1. Mungesa e informatave për vende te veçanta te Istogut 2. Mungesa e pikave, refereuese, katalogjeve dhe informatave te tjera digjitale (GIS, rrjete sociale) 3. Mungesa e kuadrit profesional per promovim brenda institucioneve lokale

5. Ekziston hapësira për Zyren e Turizmit	
MUNDËSITË 1. Aktivizimi i Qendres per Informim per zonat e rendesishme te komunës 2. Digjitalizimi dhe promovimi ne rrjete sociale i trashegimise kulturore te Istogut 3. Krijimi I një Destinacioni të Ri për turizmin e natyrës dhe kulturës	RREZIQET 1. Mungesa e mirëmbajtjes në vazhdimësi 2. Zhvillimi pa kriteret, humbja e resursve 3. Mungesa financiare

VIZIONI DREJT TE ARDHMES

Në punëtorinë e dytë, bazuar në metodologjinë e aprovuar, hisedarët janë fokusuar në vizionimin për mbrojtjen dhe integrimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në zhvillimin lokal dhe të gjendrueshëm. Deklarata e vizionit e miratuar nga hisedaret është:

Komuna e Istogut - Mjedis vital, ndërthurje e TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE si burim inspirimi për ENERGJI TË REJA KRIJUESE për ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM dhe MIRËQENIE të KOMUNITETIT VENDOR.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Bazuar në vizionin dhe analizën SWOT janë vendosuar objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Integrimi i trashëgimisë kulturore në programet e edukimit primar dhe sekondar**
- Mbrojta e vlerave/resurseve kulturore nga zhvillimet urbane, mjedisore dhe sociale**
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe industrisë krijuese me thelb në trashëgiminë kulturore dhe natyrore**
- Nxitja e bashkëpunimit dhe krijimi i mekanzimit institucional për menaxhimin e resurseve kulturore dhe natyrore - krijimi i organizimit institucional**
- Promovimi i regjionit të Istogut si destinacion i kulturës dhe natyrës**

Objektiva e përgjithshme 1 : Integrimi i trashëgimisë kulturore në programet e edukimit primar dhe sekondar dhe profesional

Objektivat Specifike

- a. Ngritja e kapaciteteve të pedagogëve dhe përmirësimi i metodave pedagogjike
- b. Edukimi joformal profesional dhe puna praktike
- c. Stimulimi i të rinjve për arsimim në trashëgimi kulturore

Aktivitetet

1. Pasurimi i përmbajtjes së monumenteve, shkrimi i narracionit, vendosja e tabelave informative
2. Përmirësimi i metodave pedagogjike interaktive për trashëgiminë kulturore dhe natyrore
3. Përgaditja e programit të lendeve zgjedhor për dijet tradicionale (kulinari, pem'tari, artizanate, mikpritje), ekologji dhe bjeshkatari, hidromonumente
4. Subvencionimi i OJQ për edukimin joformal në trashëgimi kulturore dhe natyrore (kampe, gara, festivale, ligjeratë)
5. Joshja në arkeologji (Kampe me arkeologë)
6. Dhenia e bursave për shkollë në fushat relevante të trashëgimisë kulturore

Objektiva e përgjithshme 2: Mbrojtja e vlerave/resurseve kulturore nga zhvillimet urbane, mjedisore dhe sociale

Objektivat Specifike

- a. Identifikimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Istogut
- b. Përfshirja e zonave mbrojtëse në planin lokal zhvillimor
- c. Mirëmbajtja dhe inspektimi i rregullt

Aktivitetet

1. Identifikimi i lokaliteteve, definimi i zonave mbrojtëse të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe përfshirja e tyre në Planin Zhvillimor Komunal dhe në Harten Zonale
2. Amandementimi i PZHKs dhe Hartes Zonale
3. Krijimi i njësisë së inspektoratit komunal për monitorim të trashëgimisë kulturore. Hartimi i raportit vjetor mbi gjendjen e trashëgimisë kulturore.

Objektiva e përgjithshme 3: Zhvillimi i Ndërmarrësisë dhe industrisë krijuese me fokus në trashëgimi kulturore

Objektivat Specifike

- a. Krijimi i hapësirave / inkubatoreve për start – up (ndërmarrje të reja)
- b. Grantet për start - up (ndërmarrje të reja)
- c. Trajnimie të specializuara për ndërmarrësi (shërbime, produkte, kontabilitet, etj)

Aktivitetet

1. Adaptimi/ndërtimi i hapësirave për start-up
2. Hartimi i programit për mbështetje të start up (thirrja, kriteret e përzgjedhjes, përzgjedhja, trajnimet)
3. Lansimi i progranteve të granteve vjetore për mbështetje të start-up.

Objektiva e përgjithshme 4: Nxitja e bashkëpunimit dhe krijimi i mekanizimit institucional për menaxhimin e resurseve kulturore dhe natyrore - krijimi i organizimit institucional

Objektivat Specifike

- a. Koordinimi në mes hisedareve, institucioneve dhe shoqërisë civile
- b. Harmonizimi i politikave të zhvillimit dhe të financimit të trashëgimisë kulturore
- c. Nxitja e pjesëmarrjes të komunitetëve lokale në përkujdesjen ndaj trashëgimisë kulturor

Aktivitetet

1. Hartimi i statutit të njesisë menaxhuese
2. Krijimi i njesisë menaxhuese për menaxhim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore
3. Krijimi i programit 'monumenti i mbrojtur'

Bordi
(Komuna, shoqëria civile,
komuniteti i biznesit)

Koordinatori

**Mbrojta e
Trashëgimisë
Kulturore**

**Zhvillimi socio
ekonomik përmes
trashëgimisë**

Edukimi

Promovimi

Figure 1 Skema e organizimit të njesisë menaxhuese

Objektiva e përgjithshme 5: Promovimi i Istogut si destinacion i kultures dhe natyrës

Objektivat Specifike

- a. Brendimi i Komunës së Istogut
- b. Zhvillimi i kanaleve të komunikimit dhe krijimi i infrastrukturës fizike dhe digjitale për komunikim
- c. Organizimi i ngjarjeve promovues
- d. Krijimi i qasjes fizike në lokalitetet e trashëgimisë kulturore

Aktivitetet

1. Krijimi i brendit të Komunës së Istogut
2. Krijimi i përmbajtjeve të reja (itinerarë)
3. Testimi/pilotimi i përmbajtjeve
4. Krijimi i Zyrës së Turizmit
5. Subvencionimi i OJQ-vë në sektorin e turizmit
6. Organizimi i eventeve turistike
7. Ndërtimi i rrugëve dhe shtigjeve në drejtim të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore

